



ODA EKONOMIKE
E KOSOVËS | KOSOVA CHAMBER
OF COMMERCE

Adresa: Nëna Terezë, Nr:20, 10000 Prishtinë – KOSOVE
Tel: +381 (0) 38 224 741, Tel&Fax: +381 (0) 38 224 299
info@oek-kcc.org, www.oek-kcc.org

RREGULLORE
MBI MËNYREN E PUNËS SË KËSHILLIT DREJTUES TË ODËS EKONOMIKE TË
KOSOVËS

Prishtinë, Korrik 2018

Në bazë të nenit 18 të Ligjit mbi Odën Ekonomike të Kosovës dhe nenit 27 të Statusit të Odës ekonomike të Kosovës, Këshilli Drejtues i Odës ekonomike të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20.07.2018, miratoi, këtë:

RREGULLORE
MBI MËNYREN E PUNËS SË KËSHILLIT DREJTUES TË ODES EKONOMIKE TË KOSOVËS

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e punës së Këshillit Drejtues të Odës Ekonomike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Këshilli Drejtues) dhe organeve apo trupave të tij, procedura e miratimit të akteve të Këshillit Drejtues, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Këshillit Drejtues si dhe organeve apo trupave të tij, procedura e miratimit të akteve të Këshillit Drejtues, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Këshillit Drejtues si dhe çështjet e tjera të rëndësishme për mbarëvajtjen e punës së Këshillit Drejtues.

Neni 2

Këshilli Drejtues punon dhe shqyrton çështjet nga veprimtaria e vet në seancat të cilat mbahen sipas nevojës së paku 6 herë brenda një viti kalendarik. Çdo anëtarë i Këshillit Drejtues duhet ti kryej obligimet ndaj OEK-ut, si dhe është i obliguar të merr pjesë aktivisht në mbledhjen e Këshillit Drejtues të OEK-ut. Në rast 2 mungesave të një pas njëshme apo 3 mungesa brenda vitit, mungesa të cilat nuk arsyetohen atëherë Këshilli Drejtues do ti propozoi Kuvendit për revokimin e tij nga Këshilli Drejtues dhe atë propozim do t'ia rekomandoj Kuvendit të OEK-ut, për shqyrtim dhe për moskryerjen me kohë të detyrimeve të veta i përgjigjet Kuvendit të Odës.

Neni 3

Përbërja, fushëveprimi dhe autorizimet e Këshillit Drejtues përcaktohen me Statusin e Odës Ekonomike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Oda)

Neni 4

Këshilli Drejtues i ka këto kompetenca:

- b). Merr vendime për realizimin e programeve të punës dhe zbatimin e vendimeve të tjera të Kuvendit;
- c). Emëron përfaqësuesit e Odës në institucionet, në të cilat OEK-ja delegon përfaqësuesit e saj sipas dispozitave të veçanta;
- d). Emëron këshilla të përhershme dhe këshilla të përkohshme;
- e). Miraton aktet e përgjithshme të OEK-së, të cilat nuk janë në kompetenca të Kuvendit;
- f). Vendos për hapjen e përfaqësive ekonomike në botë;
- g). Merr vendime për çështje të tjera në pajtim me Statutin e OEK-së.

Neni 5

Punën e Këshillit Drejtues e udhëheq Kryetari i Odës, pra Kryetari i Odës e thirr dhe udhëheq me punën e Këshillit Drejtues e në mungesën e tij, këtë detyrë e kryen ndonjë anëtarë i Këshillit Drejtues të cilin e autorizon Kryetari i Odës.

Neni 6

Këshilli Drejtues i OEK ka 17 anëtarë. Secili anëtarë i Këshillit Drejtues ka së paku një votë dhe një numër të caktuar votash shtesë në përpjesëtim me strukturën e kapitalit, numrin të punësuarve dhe kontributin e përgjithshëm në buxhetin e OEK-ut

Neni 7

Në propozimin e përbërjes së anëtarëve të Këshillit Drejtues, Kryetari i Odës është i obliguar të respektoj strukturën përfaqësuese 90% nga shoqatat dhe 10 % nga Njësit Rajonale, dhe kandidatët e propozuar duhet jo vetëm të kenë zotësi menaxhuese, por edhe të sigurohet përfaqësimi proporcional i sektorëve kryesor ekonomik i rajoneve duke përfshirë edhe ndërmarrjet të vogla e të mesme

Neni 8

Këshilli Drejtues do të angazhohet në harmonizimin e qëndrimeve të anëtarëve të vet, ndërsa vendos për çështjet nga veprimtaria e vet në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me këtë rregullore.

II. Seancat e Këshillit Drejtues

a). Përgatitja e materialeve për mbledhje të Këshillit Drejtues

Neni 9

Materialet që shqyrtohen në mbledhjen e Këshillit Drejtues i përgatitë shërbimi profesional i Odës.

Neni 10

Materialet e mbledhjes së Këshillit Drejtues duhet të jenë përmbledhëse dhe të qarta dhe përveç vlerësimit të gjendjes duhet të përfshijnë edhe propozimet e qëndrimeve dhe të konkluzioneve.

Neni 11

Në mbledhjen e Këshillit Drejtues mund të shqyrtohen materialet dhe propozimet të cilat i kanë përgatitur dhe propozuar ndërmarrjet, Njësitë Rajonale apo Shoqata, nëse për këtë vendos Këshilli Drejtues. Të gjitha materialet dhe prezantimet duhet të dërgohen paraprakisht me shkrim te Sekretari i Përgjithshëm Odës.

Neni 12

Propozimet për rend të ditës së mbledhjes së Këshillit Drejtues, në materialet gjegjëse i dërgohen Sekretarit të Përgjithshëm të Odës.

b). Përgatitja dhe thirrja e mbledhjeve

Neni 13

Kryetari i Odës Ekonomike përkujdeset për organizimin , përgatitjen dhe thirrjen e mbledhjeve të Këshillit Drejtues. Në përgatitjen e mbledhjeve të Këshillit Drejtues, Kryetarit të Odës i ndihmon Sekretari i Odës.

Mbledhjen e Këshillit Drejtues e konvokon Kryetari i Odës , sipas iniciativës së vet ose në bazë të konkluzës së Këshillit Drejtues si dhe me kërkesën e 1/4 të anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Neni 14

Ftesa për mbledhjen e Këshillit Drejtues, me propozim të rendit të ditës iu dërgohet anëtarëve të Këshillit Drejtues më së voni 7 ditë kalendarike para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes.

Ftesës për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit Drejtues, zakonisht i bashkohet edhe materiali që do të shqyrtohet në atë mbledhje.

Neni 15

Kryetari I Odës , përkatësisht kryesuesi i mbledhjes së Këshillit Drejtues e përcakton rendin e ditës së Këshillit Drejtues dhe iu propozon anëtarëve të Këshillit Drejtues për miratim.

Neni 16

Rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit Drejtues e përcakton Këshilli Drejtues.

c). Procedura e punës në mbledhje

Neni 17

Këshilli Drejtues i shqyrton çështjet e parashtruara në rend të ditës dhe për to vendos në mbledhje.

Vendimet, konkluzat etj, të Këshillit Drejtues janë fuqi plotë (valide) nëse në mbledhje marrin pjesë shumica e anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Neni 18

Pasi që Kryetari i Odës- kryesuesi i Këshillit Drejtues e hap mbledhjen, fillohet me shqyrtimin dhe miratimin e procesverbalit nga mbledhja paraprake.

Për vërejtjet në procesverbal të cilët i japin anëtarët e Këshillit Drejtues vendos Këshilli Drejtues, e vërejtjet e aprovuara shënohen në procesverbal.

Neni 19

Pas aprovimit të procesverbalit dhe përcaktimit të rendit të ditës, Këshilli Drejtues kalon në shqyrtimin e çështjeve nga rendi i ditës , ashtu siç janë të renditura në rend të ditës. Shqyrtimi i çdo çështjeje nga rendi ditës bazohet ose në sqarimin e propozuesit ose në sqarimet edhe me shkrim nga propozuesi.

Pas shqyrtimit të çështjes nga rendi i ditës e varësisht nga karakteri i çështjes e cila shqyrtohet, Këshilli Drejtues nxjerr vendim, konkluzë apo akt tjetër, përkatësisht përcakton propozimet e akteve të cilat i përkasin fushëveprimit të Kuvendit të Odës.

Neni 20

Nëse çështja e cila shqyrtohet në mbledhjen e Këshillit Drejtues nuk kërkon nxjerrje të ndonjë vendimi apo konkluze përkatësisht përcaktimit të propozimit, kalohet në pikën vijuese të rendit të ditës.

Neni 21

Anëtari I Këshillit Drejtues mund të paraqesë amendamente në çdo propozim ose çështje në rendin e ditës të mbledhjes së Këshillit Drejtues.

Amendamenti, zakonisht, parashtrohet me shkrim dhe atë para fillimit të mbledhjes ose gjatë shqyrtimit në seancë ,por vetëm deri me përfundimin e asaj çështje.

Nëse ka më shumë amendamente për të njëjtën çështje të rendit të ditës, Kryetari i Odës –kryesuesi i mbledhjes , amendamentet i vënë në votim sipas rendit të paraqitjes së tyre. Para se të kalohet në shqyrtimin e amendamentit të paraqitur, Kryetari i Odës – kryesuesi i mbledhjes do të kërkojë mendimin për të njëjtin nga parashtruesi i

propozimit pranon amendamentin mbi të kalohet pa shqyrtim, sepse ai është bërë pjesë përbërëse e propozimit.

Ushtruesi i amendamentit mund të tërheq amendamentin gjatë shqyrtimit , deri sa ai mos të shkojë në votim.

Nëse amendamenti aprovohet, ai bëhet pjesë përbërëse e propozimit

Neni 22

Lidhur me punën e mbledhjes së Këshillit Drejtues mbahet procesverbali, e mundësisht edhe shënime stenografike apo incizim, të cilat do ti bashkohen procesverbalit.

Procesverbali përmban të dhënat kryesore për mbledhjen ,përkatësisht për rrjedhën e saj: numrin e seancës, datën e mbajtjes, vendin e mbajtjes, orën e fillimit dhe mbarimit, numrin e të pranishmëve dhe emrat e anëtarëve të Këshillit Drejtues që mungojnë nga mbledhja, me shënim lidhur me arsyeshmërinë e mungesës si dhe emrat e personave të tjerë të ftuar që marrin pjesë në punën e mbledhjes; propozimet e paraqitura, rendin e ditës, vendimet dhe konkluzat e miratuara në mbledhjen e Këshillit Drejtues ,rezultatet e votimit për pikat e caktuara etj.

Anëtari i Këshillit Drejtues i cili në mbledhjen ka ndarë mendimin e vet mund të kërkojë që pjesët më të rëndësishme të qëndrimeve të tij të shënohen në procesverbal.

Kryetari i Odës mund të caktojë që në procesverbal të hyjnë edhe të dhënat e tjera nga mbledhja e Këshillit Drejtues.

Procesverbalin e nënshkruan Kryetari i Odës-kryesuesi i mbledhjes.

Anëtari i Këshillit Drejtues dhe pjesëmarrësit e tjerë në mbledhje kanë të drejtë të shikojnë diskutimet e veta se a janë shënuar në procesverbal dhe në to ti kryejnë përmirësimet redaktuese.

Neni 23

Për hartimin e procesverbalit ,formulimin e vendimeve dhe akteve tjera të aprovuara, implementimin dhe publikimin e tyre kujdeset Kryetari i Odës.

Për ruajtjen e procesverbaleve origjinale përkatësisht vendimeve, konkuzave dhe akteve tjera të aprovuara të Këshillit Drejtues kujdeset Sekretari i Përgjithshëm i Odës.

d). Mënyra e marrjes së vendimeve

Neni 24

Këshilli Drejtues vendos për çështjet nga fushëveprimi i vet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Nëse për ndonjë çështje ka disa propozime ose amendamente Kryetari I Odës –kryesuesi I mbledhjes I vënë në votim, sipas renditjes që janë parashtruar.

Neni 25

Votimi në mbledhjen e Këshillit Drejtues është publik, nëse Këshilli Drejtues nuk vendos ndryshe. Votimi bëhet me ngritjen e dorës ose me ftesë që çdo njëri të deklarohej veç e veç.

Deklarimin e votimit veç e veç e cakton Kryetari i Odës-kryesuesi I mbledhjes. Një nga një do të votohet edhe nëse për të kërkon një anëtarë i Këshillit Drejtues , propozimin e të cilit e përkrahin më së paku 5 anëtarë. Anëtarët e Këshillit Drejtues mund të votojnë "për" ose "kundër" propozimit për të cilin votohet ose të përmbahen nga votimi. Nëse pas publikimit të rezultateve të votimit , vërtetohet se numri I votave "për" dhe numri i votave "kundër" bashkërisht me numrin e atyre që janë përmbajtur nga votimi janë të barabartë, votimi do të përsëritet. Në rast se edhe me rivotim nuk është arritur shumica e duhur, konsiderohet se propozimi është miratuar.

e). Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Këshillit Drejtues

Neni 26

Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë të drejtë dhe për detyrë të jenë prezent në mbledhjet e Këshillit Drejtues dhe të marrin pjesë në punën dhe marrjen e vendimeve të tij.

Neni 27

Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë të drejtë që në mbledhje të iniciojnë shqyrtimin e çështjeve nga fushë veprimtaria e vet dhe të propozojnë që ato të vihen në rend të ditës.

Neni 28

Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë të drejtë të parashtrojnë pyetje trupave punuese të Odës si dhe kryetarit të Odës, lidhur me zbatimin e konkluzave të Këshillit Drejtues ose lidhur me punën e organeve tjera dhe Shërbimit profesional të Odës.

f). Dispozitat kalimtare

Neni 29

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen edhe në punën e këshillave dhe trupave të Këshillit Drejtues.

Neni 30

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit.

Neni 31

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja mbi mënyrën e punës së Këshillit Drejtues të OEK-ut, e nxjerr në shkurt të vitit 2015.

KËSHILLI DREJTUES I OEK
Prishtinë: 20.07.2018

Kryesues i Këshillit Drejtues
Berat Rukiqi

